



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit dhe Sevdail (Bajram) Dakut.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 07096-0, me sipërfaqe 363m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914059-07096-0, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-1299, dt.29.06.2010 dhe pjesë e parcelës kadastrale nr. 07109-13, me sipërfaqe 32m², Certifikata e pronësisë, nr. P- 71914059-07109-13, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-1299, dt.29.06.2010, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale nr. 07102-0, me sipërfaqe 29m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914059-07102-0, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim rrugë, sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-1299, dt.29.06.2010, në pronësi të Sevdail (Bajram) Dakut, dhe parcela kadastrale nr. 00521-1, me sipërfaqe 366m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914050-00521-1, Zona kadastrale Matiçan, me destinim rrugë dhe gjelbërim, sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-642, dt. 01.04.2010, Prishtinë, në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planeve rregulluese "Muhaxhirët" dhe "Mati 1" në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-27268/21, më 11.02.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

